

|                                                                                   |                                                                                                                                                  |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b><br>REPUBLIKA KOSOVA<br>REPUBLIC OF KOSOVA<br><b>KOMUNA E RAHOVECIT</b><br>OPSTINA ORAHOVAC<br>MUNICIPALITY OF RAHOVEC |  |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|

|               |                                                                                                                                            |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Për:</b>   | <b>Operatori Ekonomik: "Vitech" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë</b><br><b>Operatorëve Ekonomik</b><br><b>Të gjitha palëve të interesuar</b> |
| <b>Nga:</b>   | Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit        |
| <b>Lënda:</b> | <b>VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës</b>                                                                                                   |
| <b>Datë:</b>  | <b>20.05.2021</b>                                                                                                                          |

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **19.05.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "Vitech" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PAJISJA E SHKOLLAVE ME MJETE KONKRETIZIMI DHE LABORATIKE**, me Numër të prokurimit: **623-21-2242-1-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-021-1-2-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: "Vitech" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PAJISJA E SHKOLLAVE ME MJETE KONKRETIZIMI DHE LABORATIKE**, me Numër të prokurimit: **623-21-2242-1-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-021-1-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë të Autoritet Kontraktues, të datës: **22.04.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë të Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **PAJISJA E SHKOLLAVE ME MJETE KONKRETIZIMI DHE LABORATIKE**, me Numër të prokurimit: **623-21-2242-1-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-021-1-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: "Vitech" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PAJISJA E SHKOLLAVE ME MJETE KONKRETIZIMI DHE LABORATIKE**, me Numër të prokurimit: 623-21-2242-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-21-021-1-2-1, kundër Njoftimit për Kontratë të Autoritet Kontraktues, të datës: 22.04.2021, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 19.05.2021, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

#### PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

##### **6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikimi dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e kësaj aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dënimin e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anullim.*

*Në Njoftimin për Anullim janë shkelur nenet:*

- Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik (trajtimi i barabartë dhe diskriminimi)
- Është shkelur Neni 28 të LPP-se, Specifikimet teknike

**Të Ligjit nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, dhe me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

##### **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbejnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Ne si OE: Vitech Sh.p.k të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në përshkrimin teknik të pajisjeve të kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit është me se e qartë që janë vendosur specifiķa teknike të një kompanie vendore në këtë rast Behur Rama – Abetare, gjë e cila është në kundërshtim të plotë me LPP.

Mjafton një kërkim i thjeshtë i artikujve në bazë të specifikave të vendosura dhe mund të shihet qartë se specifikat teknike të kërkuara i përshkruan 100% atyre të kompanisë së lartëshënuar madje edhe renditja është pothuajse e njëjtë me artikujt në katalogun gjeneral të kompanisë Abetare.

3/5

#### PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

**Sa i përket pretendimit për shkelje të këtyre Neneve, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues e ka respektuar plotësisht Ligjin për Prokurimin Publik, andaj këto pretendime e juaj ankimor janë të pabazuara, duke dhënë arsytim si në vijime:**

Sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit nr. 7 të Ligjit të Prokurimit Publik (trajtimi i barabartë dhe diskriminues), ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, pasi që nuk e kemi kufizuar konkurrencën, për arsye se për informatën tuaj ne RKS janë minimum mbi 10 kompani të hapura me profilin të kësaj natyre në tregun e Kosovës që kanë këto produkte, pra pretendimi juaj nuk qëndron se është vetëm Kompania "Abetare". Vetëm për korrekte kompanitë të cilat ofrojnë këto

produkte ne treg janë (Infinit, Vlora, Interlab, Europrinty, Smart Plus, Liria ShPK, Era Med, Uni Lab, etj..).

Po ashtu gjeni te bashkangjitur procesverbalin e hapjes nga Autoriteti Kontraktues: Komuna e Obiliqit, për të njëjtin aktivitet te prokurimit ku janë këto kompanitë pjesëmarrëse:

**PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA**

|                                                           |                     |                                                          |                                                        |
|-----------------------------------------------------------|---------------------|----------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|
| Numri i prokurimit<br>Procurement number<br>Broj nabavke: | OB614-21-1579-1-2-1 | Titulli i Kontraktit<br>Contract Title<br>Naslov ugovora | Blerja e pajisjeve për institucionet shkollore- Obiliq |
| Numri i brendshëm<br>Internal No<br>Interni broj          | 614 21 012 121      |                                                          |                                                        |

|                                                     |                                                           |                                                                     |                                                                        |                                                                                 |
|-----------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|
| Data e lëshimit<br>Date of issue<br>Datum izdavanja | Data e mbylljes<br>Closing date<br>Datum zatvaranja & Cas | Data e hapjes & Ora<br>Opening date & time<br>Datum Otvaranja & Cas | Vendi<br>Place<br>Mesto                                                | Nr. i tenderëve të pranuar<br>No. of Received Tenders<br>Br. Primljenih Tendera |
| 19.04.2021                                          | 19.04.2021, 13:30:00                                      | 19.04.2021, 13:30:00                                                | Komuna e Obiliqit-kati i II-të sala e prokurimit për hapjen e ofertave | 4                                                                               |

| Nr. Br. | Tenderuesi<br>Tenderer                                    | Kodi i tenderit<br>Tender label/kode<br>Oznaka ponude | Pjesë<br>Lot                                                                                                                                                                                                                                                | ç-tenderit<br>e tender<br>ç-ponuda | Çmimi<br>Price<br>Cena<br>€ | Çmimi (me TVSH)<br>Price (with VAT)<br>Cena (sa PDV)<br>€ | Ndëryshimet/plotësimet<br>Supplement/Amendment<br>Dopuna/Izmena |
|---------|-----------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| 1.      | "SMART plus " SH.P.K.<br>L.Qemall,113, 10000<br>PRISHTINË | Shkollat 19.04.2021                                   | Pajisjet e shkollave me pompa për nxenje qendrorë,mjete të kopshtarisë dhe makina për pastrimin e pllakave-LOT-1                                                                                                                                            | PO                                 | 32193,64                    | 37988,50                                                  | JO                                                              |
| 2.      | "SMART plus " SH.P.K.<br>L.Qemall,113, 10000<br>PRISHTINË | Shkollat 19.04.2021                                   | Pajisjet e shkollave me me kabine të biologjisë,flakës dhe kimisë,dhe kimikale (acide) për SHFMU,,Abdurrahman Gërguri"- Dardhishitë,,Hasan Prishtina"- Millosheviç,,Pandeli Sotiri"-Obiliq,,Naim Frashëri"-Breznicë;dhe SHMLP,,Ismail Dumoshi"-Obiliq-LOT-2 | PO                                 | 33617,81                    | 39669,02                                                  | JO                                                              |

B12\_ PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

B12\_ PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

|    |                                                                                                      |                     |                                                                                                                                                                                                                                                             |    |          |          |    |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----------|----------|----|
| 3. | "Liria" SH.P.K.,Zahër Pajaziti - PODUJEVË                                                            | OB614-21-1579-1-2-1 | Pajisjet e shkollave me pompa për nxenje qendrorë,mjete të kopshtarisë dhe makina për pastrimin e pllakave-LOT-1                                                                                                                                            | PO | 30277,45 | 35727,40 | JO |
| 4. | BEHAR RAMA B.I.<br>Xhehal Hajda Toni P.n.<br>21000 RAHOVEC                                           | 203-2021            | Pajisjet e shkollave me me kabine të biologjisë,flakës dhe kimisë,dhe kimikale (acide) për SHFMU,,Abdurrahman Gërguri"- Dardhishitë,,Hasan Prishtina"- Millosheviç,,Pandeli Sotiri"-Obiliq,,Naim Frashëri"-Breznicë;dhe SHMLP,,Ismail Dumoshi"-Obiliq-LOT-2 | PO | 29237,30 | 34500,00 | JO |
| 5. | Grup i Operatorëve Ekonomik INFINITT SH.P.K.; N.T.P.<br>VI.ORA Dëshmorët e Kombit,10000<br>PRISHTINË | OB614-21-1579-1-2-1 | Pajisjet e shkollave me me kabine të biologjisë,flakës dhe kimisë,dhe kimikale (acide) për SHFMU,,Abdurrahman Gërguri"- Dardhishitë,,Hasan Prishtina"- Millosheviç,,Pandeli Sotiri"-Obiliq,,Naim Frashëri"-Breznicë;dhe SHMLP,,Ismail Dumoshi"-Obiliq-LOT-2 | PO | 32152,35 | 37939,77 | JO |

B12\_ PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit nr. 28 të Ligjit të Prokurimit Publik (Specifikat teknike), ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, pasi qe sipas Përshkrimit të Çmimeve për këtë aktivitet te prokurimit janë përshkruar artikujt te cilat nuk e kufizojnë konkurrencën, duke mos cekur asnjë kod të pajisjeve sipas katalogut të kompanisë të pretenduar nga ana juaj por edhe duke mos cekur asnjë Brand Name te një produkti te caktuar – andaj ky pretendim i juaj është i pabazuar.

**Kemi vërejtur që ndaj të njëjtit Operator Ekonomik: “Behar Rama” B.I. emër biznesi: N.T.P. “Abetare”, keni parashtruar ankesën pran OSHP-së me pretendimet e njëjta në AK: Komuna e Obiliqit, që do të thotë shumë edhe për Autoritetin tonë.**

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi  
Menaxher i Zyrës se Prokurimit  
Komuna e Rahovecit